

Bismilahirr-rrahmanirr-rrahim

Përkthimi i

**Fjalimit të Xhumasë**

të Kalifit të V-të të Xhematit Islamik Ahmedia,

**Hazret Mirza Masrur Ahmedit**

mbajtur në Xhaminë Baitul Futuh të Londrës më

**11 Qershor 2004**

Shoqërimi me të devotshmit

Hazuri e filloi fjalimin e tij me recitim të ajetit 119 të sures At-Tauba të Kuranit të Shenjtë: **“Jaa ajuhal-ladhiina aamanut-takuLlaaha wakuunuu ma’assaadikiin”**, i cili në përkthim thotë: **“O ju që keni besuar, frikësojuni Allahut dhe jini me të singertit”**.

Sa herë që Allahu ka dërguar ndonjë profet, ata që besojnë dhe e pasojnë atë profet, karakterizohen me **takvën** e tyre (frikën dhe dashurinë për Allahun). Në karakterin e tyre ndodh një ndryshim i madh pozitiv; dhe kjo është vetëm si rezultat i qëndrimit të tyre në shoqëri të atij të dërguari të Allahut. Për shkak të besimit të paluhatsëm në Allahun<sup>xhh</sup> dhe për shkak të besnikërisë ndaj profetit, si dhe për shkak të devotshmërisë me të cilën janë pajisur, ata përfshihen në grupin e atyre që janë të denjë të quhen **“saadikiin”** – të singertë dhe të vërtetë. Ata pastaj bëhen mjet përrudhje për shumë njerëz të tjerë.

Mesihu i Premtuar<sup>as</sup> ka thënë: **“Ky favor i Allahut nuk ka përfunduar, por është një proces i vazhdueshëm, përndryshe fjalët e Kuranit “kunu ma’a sadikiin” – jini me të singertët, nuk do të kishin kuptim. Po të ishte ashtu, njerëzit do të pyeshnin se cilët janë ata njerëz, të vërtetë e të singertë, me të cilët duhet të qëndrojmë, në mënyrë që të fitojmë mirësitë e Allahut?”**.

Ky është një argument i urtë, që na është mësuar nga dashnori i vërtetë i Të Dërguarit të Allahut<sup>sas</sup>, Imam Mehdiu dhe Mesihu i Premtuar<sup>as</sup>. Një komunitet i tërë i njerëzve të singertë, u krijua prej tij, të cilëve iu dha statusi i sahabëve të Profetit të shenjtë<sup>sas</sup>. Ata që janë në kërkim të mirësisë, Allahu i këshillon që të bashkohen me të devotshmit dhe të ndershmit. Ju i jeni bashkuar komunitetit të Imamit të kohës, dhe ju duhet ta bëni atë reformë të pastër në vetën tuaj, dhe të bëheni kështu burim udhëzimi për të tjerët. Përndryshe, sipas premtimit të Allahut, njerëz të devotshëm vazhdimisht do të vinë në botë, por, nëse ne bimë në humnerën e shkatërrimit, atëherë një grup tjetër i të devotshmeve do të ngrihet nga Allahu i Madhërishëm, i cili do t’i shërbejë Allahut më mirë. Pra, ne gjithmonë duhet të jemi të përrulur para Allahut dhe t’i lutemi Atij që ne të jemi nga ajo grup që janë të lidhur me Imamin e kohës dhe të cilët përfitojnë nga këshillat e tij dhe të jemi burim udhëzimi për të tjerët; e jo të jepemi pas botës materiale e të largohemi nga feja dhe të bëhemi kështu shënjestër e sulmeve të djallit. Dhe kur djalli ju sulmon, ai ju bën të anoni nga kënaqësitë e kësaj bote

materiale. Pra, ju duhet të ecni shumë kujdesshëm në jetën tuaj, duke qenë gjithmonë të përvuilur para Allahut të Madhërishëm dhe duke iu lutur. Ne gjithmonë duhet të mendojmë se cila është rruga të cilën duhet ta pasojmë? Ne duhet t'i pasojmë këshillat e Mesihut të Premtuar<sup>as</sup>, prandaj, është shumë e rëndësishme që t'i lexojmë veprat e Mesihut të Premtuar<sup>as</sup>, dhe kjo bie në kategorinë e të qëndruarit në shoqërinë e të devotshmëve. Lidhur me këtë, Hazret Musleh Maud (Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar<sup>as</sup>), ka thënë: *“Është zakonisht shoqëria e keqe që i çon njerëzit kah shkatërrimi. Së pari njeriu i pëlqejnë shokët e tillë, ndërsa më vonë thotë: Ah sikur të mos isha shoqëruar me filanin e fistekun. Ata më shpien në humnerë. Për këtë arsye Kurani i shenjtë këshillon: “**Kunu ma’a sadikiin**” – rrini me të devotshmit. E vërteta është se njeriu nuk mund të mbrohet nga ndikimi i shoqërisë së keqe. Në anën tjetër, ata që kanë përparuar në devotshmëri, ndikojnë në ata që shoqërohen me ta dhe ata gradualisht përparojnë shpirtërisht. Por, nëse dikush zgjedh shoqëri të gabuar, ajo kurrë nuk do t'i shpie ata nga diçka e mirë. Pastaj Hazret Musleh Maud<sup>rah</sup>, e rrëfen rastin e një studenti që ishte nga pasuesit e devotshëm të Mesihut të Premtuar. Ai i shkroi një herë Mesihut të Premtuar<sup>as</sup>, duke i thënë se më parë kisha besim të fortë në Zotin, por tani më kanë lindur disa dyshime. Mesihu i Premtuar iu përgjigj duke i thënë se si duket dikush nga shokët tuaj të ngushtë është ateist dhe është duke ndikuar në ty. Ti duhet ta ndërrosh bankën ku zakonisht ulesh. Ai e ndërroi bankën dhe menjëherë ndryshoi”*. Kjo tregon se shoqëria ka ndikim të madh në njerëz. Për këtë arsye, sa herë që Profeti i shenjtë<sup>sas</sup>, ishte në shoqëri të të tjerëve, bënte istahgfar, pra, kërkonte falje dhe mbrojtje nga Allahu<sup>xhh</sup> në mënyrë që asgjë negative të mos mund të ndikonte në të.

Ka një hadith i cili është shumë i rëndësishëm për prindërit, për të rinjtë dhe për ata që tani po arrijnë në moshën madhore. Në fakt ky është një hadith i rëndësishëm për të gjithë ne. Transmetohet nga Hazret Ebu Hureira<sup>rah</sup> se e ka dëgjuar Profetin e shenjtë<sup>sas</sup>, duke thënë: *“Njeriu është në fenë e shokut të tij”*. Pra ju duhet të jeni shumë të kujdesshëm se me kë shoqëroheni. Prindërit gjithashtu duhet të shikojnë se cilët janë shokët e fëmijëve të tyre. Kjo nuk do të thotë që të tregoheni të ashpër ndaj tyre. Në fakt, më shumë sukses do të keni nëse do të jeni miqësor ndaj tyre. Kam thënë shumë herë se në ditët tona, për shkak të mjeteve të telekomunikacionit, ndikimi i kulturës së perëndimit dhe sulmet e djallit janë prezentë gjithkund, prandaj është e rëndësishme t'i kundërshtoni këto sulme djallëzore. Prindërit duhet të mbajnë marrëdhënie miqësore me fëmijët e tyre dhe kjo është shumë e rëndësishme. Ata që vijnë në Perëndim, në fillim janë shumë strikt, por më vonë bëhen të shkujdesur dhe e humbin shoqërinë me fëmijët e tyre. Ata duhet ta mbajnë atë klimë miqësore e cila do t'u mundësojë që t'i kontrollojnë fëmijët e tyre dhe të jenë në gjendje t'i diskutojnë problemet e ndryshme me ta. Për t'i afruar fëmijët nga feja, për t'u dhënë atyre respekt për fenë dhe për t'i lidhur ata me Allahun<sup>xhh</sup>, duhet punë. Prindërit duhet të bëjnë përpjekje në këtë drejtim me ndihmën e lutjeve. Por, një gjë duhet të jetë e qartë se, asgjë nuk mund të arrihet përderisa prindërit të mos

jenë vetë të devotshëm. Me kujdes duhet të shikoni se cilët janë shokët e fëmijëve tuaj dhe duhet t'i njihni mirë ata. E keni dëgjuar shembullin e atij studenti i cili vetëm duke u ulur afër një studenti tjetër ateist, ishte ndikuar nga mendimet e tij. Pra me gjithë përsëritjen e këtyre këshillave, shumë ankesa kanë arritur. Kjo është, ose për shkak se prindërit kanë qenë shumë të ashpër ndaj fëmijëve të tyre ose për shkak se kanë qenë tepër të butë ndaj tyre dhe si rezultat fëmijët e tyre kanë dalë jashtë kontrollit. Ka fëmijë që janë shumë të lidhur me Xhematin dhe marrin pjesë në të gjitha aktivitetet e Xhematit, por me të arritur moshën pesëmbëdhjetë – gjashtëmbëdhjetë vjeçare, papritmas fillojnë të largohen, derisa më në fund i shkëpusin lidhjet edhe me prindërit e vet. Kjo është duke ndodhur edhe me vajzat gjithashtu; dhe kjo është një situatë shumë dëshpëruese. Nëse do të kishit qenë të kujdesshëm ndaj fëmijëve tuaj që nga mosha e njomë, këto gjëra nuk do të kishin ndodhur. U them edhe fëmijëve: zgjidhni me mençuri shokët tuaj dhe mos mendoni se prindërit tuaj janë armiq të tuaj. Mosha 16-17 vjeçare është shumë delikate dhe ju duhet ta shihni vetë se a janë të mirë ose jo shokët tuaj. Ta dini se nuk janë shokë të mirë ata që ju largojnë nga Allahu i Madhërishëm. Shokët e tillë nuk mund të jenë dashamirësit dhe miqtë tuaj të vërtetë. Pra, mos i jepni familjes suaj emër të keq, mos e dëmtoni veten tuaj duke u shoqëruar me shokë të tillë dhe gjithmonë rrini të lidhur ngushtë me Xhematin. Jini të vëmendshëm në namazet tuaja, në leximin e Kuranit të shenjtë dhe në kryerjen e obligimeve tjera. Allahu i mbrojtë fëmijët tanë nga ndikimi i djallit.

Transmetohet nga H. Ebu Musa Ashari se e ka dëgjuar Profetin e shenjtë<sup>sas</sup> duke thënë: *“Shembulli i shokut të mirë dhe atij jo të mirë është si shembulli i një njeriu që ka një dyqan parfumeshe dhe një tjetri që ka një dyqan farkëtarie. Nëse futeni në dyqanin e atij që shet parfume, kur të dilni prej aty do t'u vjen era parfum. Nëse hyni në dyqanin e farkëtarit, do t'u vijë era tym kur të dilni prej aty”*.

Na bëftë Allahu nga ata që janë të parfumosur me aromën e afërsisë së Allahut dhe të jemi shoqëri e atillë që të tjerët të ndikohen pozitivisht nga ne. Mesihu i Premtuar<sup>as</sup>, thotë: *“Shoqëria me të cilën njeriu rri gjithmonë ndikon në të. Njerëzit e devotshëm kanë një ndikim shumë të madh te të tjerët. Unë ju them me të vërtetë se shoqërimi me profetë dhe auliya mund të arrihet duke i pasuar ata. Kjo është arsyeja pse Kurani i shenjtë thotë: “Kunu ma’a sadikin” – jini me të devotshmit. Është mirësi e Allahut që në çdo epokë ka njerëz të tillë”*.

Është një hadith i gjatë, të cilin do ta lexoj vetëm pjesërisht, në të cilin H. Ebu Hureira<sup>ran</sup> transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut<sup>sas</sup> duke thënë: *“Ka disa engjuj të Allahut të Madhërishëm që vazhdimisht janë në kërkim të atyre njerëzve që e përkujtojnë Allahun, dhe kur e gjejnë ndonjë tubim ku përkujtohet Allahu, e mbulojnë atë me krahët e tyre. Kur ata shpërndahen, engjujt kthehen në qiell dhe dalin para Allahut”*. Pastaj këtu përshkruhet biseda e Allahut me këta engjuj dhe më në fund, Allahu<sup>xhh</sup> thotë: *“Do t'i falë dhe do t'u jap gjithçka*

*që kërkonin prej Meje. Atëherë engjëjt do të thonë se me ta ishte edhe një tjerë njeri jo i devotshëm, i cili vetëm po kalonte atypari dhe u ul me ta. Allahu do të thotë se do falë edhe atë, sepse ata janë të atillë që kushdo që ulet me ta ndikohet prej tyre”.*

Mesihu i Premtuar<sup>as</sup> thotë se: *“Ata që e lënë shoqërinë e të devotshmëve dhe fillojnë të shoqërohen me të këqijtë, ata do të ndikohen nga e keqja e tyre. Kjo është arsyeja pse Allahu ka urdhëruar që të qëndrojmë me të devotshmit. Gjithashtu jemi urdhëruar që nëse diku fyhet emri i Allahut dhe i Profetit të Tij, të largohemi nga ajo shoqëri. Ata që e kërkojnë shoqërinë e të devotshmëve dhe shoqërohen me ta, ata llogariten si pjesë e tyre. Të shoqëruarit me njerëzit e mirë është veti e shkëlqyer. Allahu ka thënë se engjëjt dërgohen te ata që janë të angazhuar në përkujtimin e Allahut. Pra, fatkeq janë ata që rrinë larg të devotshmëve”.*

Në një vend tjetër Mesihu i Premtuar thotë: **“Kunu ma’a saadikiin”** – qëndroni në shoqëri me të devotshmit, sepse në secilën vepër që e bëjnë, të dukshme ose të padukshme, janë të drejtë, të singertë dhe të pastër. Para kësaj Allahu thotë: **“ja ejuh-el-ladhina amanu ttakullah”** – O ju që keni besuar, kijeni frikë Allahun. Kjo demonstroi se ata para së gjithash janë në kërkim të afërsisë së Allahut, përmes shoqërisë së devotshme”.

Një njeri i cili shkon dhe shihet me gra të këqija dhe pastaj thotë, a mos kam bërë amoralitet? Thoni atij, po, së shpejti do të bësh amoralitet. Ai njeri i cili shkon rregullisht në pijetore, ai gradualisht do të fillojë të pijë edhe vetë. Kjo është arsyeja pse Allahu ka thënë *“kunu ma’a sadikin”*. Nëse një njeri vazhdimisht silltet në një ambient jo të shëndoshë, edhe nëse e kundërshton, gradualisht mospëlqimi dhe opozita e tij do t’i dobësohen, dhe përfundimisht do të bëhet si ata. Pra, nëse dikush shkon në vende ku pihet alkooli është shumë e mundshme që edhe ai vetë të fillojë të pijë. Kjo është arsyeja pse në hadithet e Profetit të shenjtë, porositet me aq stres që t’ju shmangemi vendeve ku përdoren gjërat e ndaluara.

Kalifi i Katërt (rahimahullah – Allahu pastë mëshirë ndaj tij), thoshte se ata që janë punësuar në ato vende ku shitet ose përdoret alkooli, atyre u këshillohet që t’i lënë ato vende të punës. Edhe ata që punojnë nëpër restorante, ku duhet të punojnë me mish derri dhe ta shërbejë atë, edhe atyre u këshillohet që t’i lëshojnë ato vende të punës. Mesihu i Premtuar<sup>as</sup> thotë se nëse qëndroni në atë ambient, ekziston një rrezik tepër i madh që një ditë jo të largët, të filloni e t’i përdorni edhe vetë të njëjtat gjëra. Pra, ata duhet t’i lënë ato punë dhe të kërkojnë ndonjë punë tjetër më të mirë dhe më të pastër; dhe nëse e bëjnë këtë për hir të Allahut, Allahu do t’u ndihmojë atyre. Kjo gjithashtu do t’u ndihmojë që ta pastrojnë shpirtin e tyre.

Mesihu i Premtuar<sup>as</sup> thotë: *“Janë dy gjëra shumë të rëndësishme: njëra është namazi dhe tjetra qëndrimi me të devotshmit. Në atë shoqëri pastaj, ju do të jeni*

*në gjendje ta kuptoni se Zot juaj është i Gjithëfuqishëm, i pranon lutjet dhe iu jep bekime të panumërta shërbëtorëve të Tij”.*

Hazuri tha më pastaj se në kohën tonë, krahas namazit dhe lutjeve, ju gjithashtu duhet të përfitoni nga shkrimet e Mesihut të Premtuar, nga komentimet e Kuranit të shenjtë që ai i ka bërë. Nëse dëshironi ta kuptoni Kuranin e shenjtë dhe nëse dëshironi t’i kuptoni hadithet, ju duhet t’u ktheheni librave të Mesihut të Premtuar. Një përparësi të madhe këtu e kanë ata që dinë urdu, sepse shumica e librave të Mesihut të Premtuar janë të shkruara në urdu, përveç disave në arabisht dhe persisht. Ata që nuk mund të lexojnë, duhet të kërkojnë ndihmë prej të tjerëve ose të shikojnë programet e MTA-së. MTA-ja duhet gjithashtu të prezantojë me përkthim më shumë nga shkrimet e Mesihut të Premtuar. Allahu na mundësoftë të jemi nga të devotshmit. Amin!

<b>Note:</b>	This is an Albanian translation of Hazoor’s Khutba
of:	
<b>11 June 2004</b>	The topic of this Khutba is:
<b>‘Company of the Righteous’</b>	This translation has been prepared by the
members of Kosovo Jam’aat	